

Zhvillimi multidimensional i pjesëmarrësve


Veçanërisht në kontekstin e sportit për zhvillim, sporti është më shumë sesa 'thjesht' ushtrime fizike dhe trajnim i shkathtësive. Koncepti i zhvillimit multidimensional e përfshinë këtë element duke vendosur fokusin jo vetëm në zhvillimin sportiv të pjesëmarrësve (të rinjve) por, në vend të kësaj, përfshinë tërë gamën e dimensioneve që kontribuojnë në zhvillimin e gjithmbarshëm të pjesëmarrësve (të rinjve). Si gjithmonë, duhet pasur parasysh se ekzistojnë pesë parime kryesore, dhe se S4D mund ta zhvillojë potencialin e vetë të plotë vetëm nëse merren parasysh dhe zbatohen të gjitha parimet.

Zhvillimi multidimensional është parim gjithëpërfshirës dhe këtë duhet ta kenë parasysh trajnerët e S4D gjatë të gjitha sesioneve të trajnimit për S4D. Për trajnerin është me rëndësi që t'i shmanget zhvillimit një-dimensionaltë pjesëmarrësve (të rinjve) që fokusohet për së tepërmi në progresin në sport. Pra, një sesion i trajnimit të S4D gjithmonë duhet ta nxisë zhvillimin e 4 dimensioneve të mëposhtme.



Zhvillimi kognitiv

Zhvillimi kognitiv ka të bëjë me progresin që të rinjtë e arrijnë në të kuptuarit e botës dhe marrëdhënieve të saj, si dhe proceset e mësim-nxënies me të cilat njerëzit fitojnë njohuri lidhur me mjedisin e tyre dhe, në këtë mënyrë, e zhvillojnë inteligjencën e tyre. Qëllimi është që t'i përmirësojmë shkathtësitë kognitive që kontribuojnë në zhvillimin e të menduarit kritik.



Zhvillimi social

Zhvillimi social mund të përkufizohet si proces i socializimit ku përfshihen krijimi i lidhjeve emocionale, përvetësimi i vlerave, njohurive dhe normave shoqërore, shprehje të të mësuarit, roleve dhe sjelljeve shoqërore për ta lehtësuar përshtatjen. Qëllimi është që të fuqizohen shkathtësitë personale që kontribuojnë në zhvillimin e strukturës shoqërore.


Zhvillimi i ndërlidhur me sport

Zhvillimi që ndërlidhet me sportin duhet të synojë përmirësimin e shkathtësive teknike, taktike dhe motorike që kërkohen për një sportpërkatës, dhe ta inkurajojë avancimin e performancës së shkëlqyeshme atletike.

Zhvillimi fizik

Zhvillimi fizik përfshin ndryshimet fizike nëpër të cilat kalon çdo qenie njerëzore, dhe të cilat kanë një efekt të veçantë në peshë dhe lartësi, duke përfshirë edhe zhvillimin e kockave dhe muskujve. Qëllimi është që t'i promovojë shkathtësitë e përgjithshme motorike, shprehje të shëndetshme dhe mirëqenien fizike.

Në këtë drejtim, sesion i trajnimit për S4D duhet të kuptohet si një njësi sistematike pedagogjike që synon t'i promovojë të katër dimensionet e zhvillimit në mënyrë që pjesëmarrësit (të rinjtë) të jenë në gjendje të arrijnë rezultate më të mira në kontekste të ndryshme të jetës së përditshme. Detyra e trajnerit është që ta gjejë ekuilibrin më të përshtatshëm ndërmjet zhvillimit kognitiv, social, të ndërlidhur me sportin dhe zhvillimit fizik të pjesëmarrësve (të rinjve).



Integrimi i **zhvillimit të shkathtësive jetësore** dhe duke qenë të fokusuar në **strukturën e sesionit të trajnimit** mund të ndihmojë që të arrihet ky ekuilibër. Mënyra ideale do të ishte që dimensionet e ndryshme të zhvillimit të mos shihen si kundërshtues, por si plotësues të njëri-tjetrit. Trajnerët duhet ta kenë parasysh që **zhvillimi multidimensional nuk nënkupton një zhvillim të standardizuar**. Pjesëmarrësit (të rinjve) do të jenë në faza të ndryshme të zhvillimit, që do të thotë se ju duhet ta përshtatni zbatimin e katër dimensioneve në përputhje me kontekstin personal dhe social të pjesëmarrësve. Më shumë informata lidhur me këtë mund të gjenden në kursin bazik mbi **Qëllimet e përshtatshme arsimore**.

Si pjesë e zhvillimit multidimensional, **të nxënit e bazuar në argëtim** përfaqëson një koncept të rëndësishëm që duhet të jetë në qendër të të gjitha aktiviteteve të S4D.

Kjo ndihmon që të ndërliken pesë parimet kryesore, ndërsa trajneri i S4D duhet ta trajtojë atë gjithmonë si element themelor. Para së gjithash, duhet të sigurohet që **pjesëmarrësit e rinj të vihen në qendër të të gjitha aktiviteteve**.

Në mënyrë që pjesëmarrësit e rinj ta zhvillojnë potencialin e tyre të plotë dhe t'i fitojnë shkathtësitë e rëndësishme jetësore nëpërmjet S4D, ata duhet të jenë në gjendje të kënaqen dhe të argëtohen gjatë mësimin. Të nxënit e bazuar në argëtim është edhe mjet për ta arritur një qëllim dhe qëllim në vetvete. Ai i motivon pjesëmarrësit e rinj që të marrin pjesë në sesionet e trajnimit, në radhë të parë, dhe e promovon procesin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit të shkathtësive.


Sporti ofron një mundësi të shkëlqyeshme për aplikimin e të nxënit të bazuar në argëtim. Ai ka aftësi që t'i tërheqë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit, në mënyrën që masat tradicionale të arsimit nuk mundën. Mirëpo, të nxënit të bazuar në argëtim nuk është i sigurt dhe nuk duhet të merret si i mirëqenë.

Kur planifikohet dhe zhvillohet një sesion trajnimi, trajneri duhet **t'i shqyrtojë aktivitetet nga këndvështrimi i pjesëmarrësve të rinj**.

Pjesëmarrësit e rinj do të përfitojnë shumë nëpërmjet të nxënit të bazuar në argëtim. Përfitimet përfshijnë, për shembull:

- ✓ Pjesëmarrje më të rregullt në sesionet e trajnimit
- ✓ Motivim dhe vëmendje e shtuar gjatë sesioneve të trajnimit
- ✓ Zhvillim më të qëndrueshëm të shkathtësive jetësore

Prandaj, duhet pasur parasysh disa këshilla të dobishme, të cilat mund të rrisin suksesin e sesioneve të trajnimit dhe t'i bëjnë ato më argëtuese.



Më shumë informata mund të gjenden në kurset bazike lidhur me **Rolet dhe përgjegjësitë e trajnerit** dhe mbi zhvillime **Qëllimeve të përshtatshme arsimore**.

Si do tazhvillojin pjesëmarrësit e mi aktivitetin për vetveten?